



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
KOMISIONI I ANKIMIT

Nr. 768/ prot.
8

Tiranë, më 01.06.2026

VENDIM

Nr. 13 datë 01/06/2026

“Për refuzimin e ankimit të organizatës jofitimprurëse “Qendra Psiko - Sociale Vatra” ndaj Vendimit të Komisionit të Vlerësimit Nr. 08, datë 14.05.2026, për refuzimin e aplikimit për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti”

Komisioni i Ankimit i përbërë prej:

Z. Erjon Ndreca - Kryetar
Znj. Sindi Prifti - Anëtar
Znj. Arsilda Mamica - Anëtar

asistuar nga Sekretariati Teknik, sot, me datë 01.06.2026, mori në shqyrtim ankimin administrativ, për refuzimin e aplikimit për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, të organizatës “Qendra Psiko - Sociale Vatra”, depozituar pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas me datë 20.05.2026, Nr. 768/7 Prot, me të dhënat e mëposhtme:

ANKUES: “Qendra Psiko - Sociale Vatra”, përfaqësuar nga znj. Brikena Puka, Drejtore Ekzekutive.

OBJEKTI: Ankimi ndaj Vendimit të Komisionit të Vlerësimit Nr. 08, datë 14.05.2026, administruar nga DNJF, me Nr. 768/6 Prot, datë 14.05.2026, “Për kërkesën për përfitim financimi të Organizatës Jofitimprurëse “Qendra Psiko - Sociale Vatra”.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 111/2017, datë 14.12.2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”; (i ndryshuar).

Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 4, datë 07.01.2025, “Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizura nga Ministri i Drejtësisë”, (i ndryshuar me Urdhri nr. 124 datë 10.02.2026)

Komisioni i Ankimit, pasi shqyrtoi pretendimet e ankuesit që ndër të tjera kërkon *“rishikimin e procedurës dhe pranimin e kërkesës duke e konsideruar si të padrejtë përjashtimin, pasi pretendohet se ka paraqitur pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas një deklaratë zyrtare në të cilën specifikohet qartë se linja buxhetore për shërbimin e avokatit, në kuadër të ndihmës juridike parësore, nuk është e përfshirë në buxhetin e projektit të financuar nga UNDP. Kjo linjë është parashikuar të mbulohet nga DNJF me qëllim shmangien e çdo mbivendosje financimi.*

VËREN SE:

Referuar dokumentacionit të përcjellë në aplikimin e Organizatës Jofitimprurëse *“Qendra Psiko - Sociale Vatra”*, rezulton se Komisioni i Vlerësimit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, me Vendimin Nr. 08, datë 14.05.2026, **vendosi unanimitisht refuzimin e aplikimit për financim.**

Pranë Komisionit të Ankimit në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas me datë 20.05.2026, Nr. 768/7 Prot., është administruar ankimi i *“Qendra Psiko - Sociale Vatra”*, përfaqësuar nga znj. Brikena Puka, Drejtore Ekzekutive.

Kundër Vendimit të Komisionit të Vlerësimit Nr. 08, datë 14.05.2026, në ankimin e saj me shkrim znj. Puka, përfaqësuese e *“Qendra Psiko - Sociale Vatra”*, ka parashtruar se:

- Përjashtimi konsiderohet i padrejtë pasi, pretendon se ka paraqitur pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas një deklaratë zyrtare në të cilën specifikohet qartë se linja buxhetore për shërbimin e avokatit, në kuadër të ndihmës juridike parësore, nuk është e përfshirë në buxhetin e projektit të financuar nga UNDP. Kjo linjë është parashikuar të mbulohet nga DNJF me qëllim shmangien e çdo mbivendosje financimi.

Në vijim të këtyre pretendimeve, ankuesi ka kërkuar *“rivlerësimin e aplikimit duke bashkëngjitur me ankimin, projektin dhe buxhetin përkatës të aprovuar nga UNDP.*

Rrethanat faktike të çështjes

Pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është administruar kërkesa e organizatës jofitimprurëse *“Qendra Psiko - Sociale Vatra”* protokolluar me Nr. 768 Prot., datë 13.03.2026, Organizata Jofitimprurëse ka aplikuar për financim nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.

Bazuar në kriteret e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”*, i ndryshuar si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 4, datë 07.01.2025, *“Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara nga Ministri i Drejtësisë”*, i ndryshuar me Urdhrit nr. 124, datë 10.02.2026, organizata ka përcjellë dokumentacionin i cili është marrë në shqyrtin nga komisioni i vlerësimit.

Komisioni i Ankimit konstaton se Komisioni i Vlerësimit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuara ngritur me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 104, datë 19.02.2026, ka marrë në dorëzim dhe shqyrtim dokumentacionin e përcjellë nga organizata, dokumentuar me Relacionin nr. 768/1 prot., datë 01.04.2026 “*Mbi kërkesën për financim nga organizata jofitimprurëse e autorizuar “Qendra Psiko Sociale Vatra”*”. Në këtë relacion janë evidentuar mangësitë në dokumentacionin e përcjellë të cilat përbënin shkak skualifikimi. Në përputhje me parashikimet e VKM së sipërcituar Komisioni i Vlerësimit ka njoftuar organizatën jofitimprurëse për plotësimin e kërkesës, nëpërmjet dërgimit të dokumentacionit plotësues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit.

Me shkresën nr. 768/2 prot., datë 02.04.2026, me lajmërim marrje (RR814402893AA), të marrë nga Organizata jofitimprurëse “*Qendra Psiko-Sociale Vatra*” në datën 07.04.2026, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit plotësues, si më poshtë:

1. Certifikata e regjistrimit NIPT nr. serial 41240111378;
2. Akti i autorizimit nga Ministri i Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore, i marrë në vitin 2025;
3. CV dhe kontrata e datës 01.01.2026–31.03.2026 për z. Daron Tozaj, në pozicionin “Avokat”;
4. Plani financiar i nënshkruar nga drejtori ekzekutiv.

Në vijim, me shkresat nr. 768/3 prot., datë 09.04.2026 dhe nr. 768/4 prot., datë 14.04.2026, organizata jofitimprurëse “*Qendra Psiko-Sociale Vatra*” ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me kërkesën e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Nga verifikimi i dokumentacionit Komisioni i Vlerësimit ka konkluduar se organizata ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

Komisioni i Vlerësimit, pas administrimit të dokumentacionit të plotë, ka vijuar me shqyrtimin e tij për të verifikuar përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta. Në këtë kuadër, me shkresën nr. 768/4 prot., datë 14.04.2026, organizata ka përcjellë deklaratën nr. 821 prot., datë 10.04.2026, në të cilën deklaron se, njëkohësisht me aplikimin pranë DNJF-së, ka aplikuar pranë UNDP me projektin “*Accessible Justice for Vulnerable Women and Girls, ëith special focus on victims of violence and exploitation-EQUALS*”.

Gjithashtu, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka marrë dijeni në datën 08.04.2026, nëpërmjet komunikimit zyrtar elektronik nga përfaqësues të UNDP-së, se organizata jofitimprurëse “*Qendra Psiko-Sociale Vatra*” është shpallur fituese në kuadër të projektit EQUALS, i cili parashikon ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore për një periudhë 12-mujore në disa qytete (Vlorë, Himarë, Selenicë, Fier, Lushnje dhe Berat).

Komisioni i Vlerësimit ka krijuar bindjen se nga analiza krahasimore e përmbajtjes së projektit të financuar nga UNDP dhe e aplikimit të paraqitur pranë DNJF-së, rezulton se aktivitetet e propozuara kanë të njëjtin objekt thelbësor, konkretisht ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategori vulnerabel, e cila do të ofrohet dhe në qytete të njëjta konkretisht në Vlorë.

Në këtë kuptim, pavarësisht elementeve të tjerë formale, natyra e aktivitetit, vendi dhe rezultati i synuar mbeten të njëjta, pasi kriteri i përcaktuar në legjislacionin në fuqi lidhet me përmbajtjen dhe objektin e aktivitetit të financuar.

Komisioni i Vlerësimit ka konkluduar se kjo situatë përbën mbivendosje të burimeve të financimit për të njëjtin aktivitet, në kundërshtim me gërmën “a”, nënndarja “ii”, të pikës 6 të VKM-së nr. 110, datë 06.03.2019, të ndryshuar.

Në përfundim të procesit të vlerësimit, si dhe në zbatim të gërmës a, ii), të pikës 6 dhe pikës 7 të VKM-së nr. 110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre” të ndryshuar, sipas së cilës mosplotësimi i një prej kriterëve të veçanta sjell moskualifikimin e aplikimit, Komisioni i Vlerësimit vlerësoi se organizata **nuk përmbush këtë kriter.**

Komisioni i Vlerësimit ka vendosur unanimitisht që organizata jofitimprurëse “Qendra Psiko-Sociale Vatra” të mos kualifikohet për përfitimin financiar, për shkak të përfitimit të njëkohshëm të financimit nga një burim tjetër për të njëjtin aktivitet, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në VKM-në nr. 110/2019, të ndryshuar.

Vlerësimi i Komisionit të Ankimit mbi procedurat e ndjekura në kuadër të aplikimit të “Qendra Psiko - Sociale Vatra”, për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit.

Në mbështetje të pikës 5 të VKM nr. 110, datë 6.3.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas ka ndërmarrë masat për publikimin në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të thirrjes për financimin e OJF-ve të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore (Afati i aplikimit 16.02.2026 - 16.03.2026):

- Buletini nr. 4, viti 2026: <https://qbz.gov.al/eli/bnjz/2026/4/0cdd63ac-bd59-4aec-ac66-232c3546e049;q=P%C3%ABr%20shpalljen%20e%20thirrjes%20p%C3%ABr%20financimin%20e%20OJF-ve%20t%C3%AB%20autorizuara%20p%C3%ABr%20ofrimin%20e%20Ndhm%C3%ABs%20Juridike%20Par%C3%ABsore,%20viti%202026%E2%80%9D>.

Gjithashtu, thirrja për financim është publikuar edhe në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, në rubrikën njoftime, si vijon:

- link: <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/newsroom/njoftime/>

Në këtë kuadër me qëllim trajtimin e aplikimeve të paraqitura në afatet e mësipërme, në zbatim të VKM Nr. 110, datë 06.03.2019 i ndryshuar, me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr. 104 Prot., datë 11.02.2026, u ngrit Komisioni i Vlerësimit dhe i Ankimit.

Pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është administruar kërkesa e organizatës jofitimprurëse “Qendra Psiko - Sociale Vatra”, protokolluar me Nr. 768 Prot., datë 13.03.2026, e cila rezulton e autorizuar nga Ministri i Drejtësisë. Kjo kërkesë rezulton e paraqitur brenda afatit të thirrjes (Afati i aplikimit 16.02.2026 - 16.03.2026).

Në vijim të trajtimit të këtij aplikimi, me Vendimin Nr. 8 datë 14.05.2026, Komisioni i Vlerësimit refuzoi aplikimin e organizatës jofitimprurëse “Qendra Psiko - Sociale Vatra”.

Vendimi Nr. 8 datë 14.05.2026, iu komunikua organizatës nëpërmjet shërbimit postar. Sipas informacionit të marrë pranë shërbimit postar, organizatës i është komunikuar vendimi me datë 18.05.2026.

Me shkresën e protokolluar pranë Drejtorisë me Nr. 768/7 Prot., datë 20.05.2026 organizata ka ushtruar të drejtën e ankimit. **Ky ankim është bërë brenda afatit pesë ditor të parashikuar në pikën 16 të VKM-së Nr. 110, datë 06.03.2019.**

Komisioni i Ankimit duke u bazuar në procedurat e mësipërme, mbi dokumentacionin e depozituar nga organizata, parashtrimet e paraqitura në ankim, dhe vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit, konstaton se:

Bazuar në Pikën 2, të VKM Nr. 110, datë 06.03.2019, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”*, i ndryshuar rezulton se procedurat e përfitimit të financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara janë bërë duke u bazuar në parimet:

- a) konkurrueshmërisë;
- b) trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara, që paraqesin kërkesën për përfitimin e financimit;
- c) transparencës të të gjitha fazave që lidhen me shqyrtimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuara;
- ç) kritereve të mirëpërcaktuara dhe publike, të cilat do të mundësojnë vlerësimin e propozimeve të organizatave jofitimprurëse të autorizuara në raport me objektivat dhe prioritetet e mbështetjes financiare;
- d) efektivitetit dhe ekonomizimit në shfrytëzimin e fondeve publike, duke siguruar që të arrihen objektivat dhe prioritetet e përcaktuara me një kosto sa më të favorshme për realizimin e shërbimit të synuar;
- dh) respektimit të plotë të parimeve të llogaridhënies dhe raportimit në përdorimet e fondeve publike;
- e) financimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë e përfituesve që janë me prioritet për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe në interes të përfituesve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;
- ë) ruajtjes së pavarësisë së organizatës jofitimprurëse të autorizuar;
- f) parandalimit të konfliktit të interesit, si dhe të çdo aktiviteti tjetër që rrezikon ofrimin me integritet të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Në Pikën 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019 i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: *“Për t’u kualifikuar për të përfituar financime, organizatat jofitimprurëse të autorizuara duhet të plotësojnë **kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, përfshirë këtu edhe kërkesa të tjera specifike që mund të jenë të nevojshme për ofrimin e ndihmës juridike parësore, sipas thirrjes publike të veçantë”**.*

Këto kërkesa specifike janë përcaktuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 4, datë 07.01.2025, *“Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara nga Ministri i Drejtësisë”*, (i ndryshuar me Urdhrin nr. 124, datë 10.02.2026), të cilat lidhen me prioritetet e kërkuara dhe targetin për secilin prioritet.

Evidentohet se organizata në përputhje me Pikën 6 të VKM Nr. 110, datë 06.03.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre” i ndryshuar, ka depozituar dokumentacionin e kërkuar, referuar të cilit, Komisioni i Vlerësimit në analizë përmbajtësore ka konkluduar në mosplotësimin e kriterëve të përgjithshme, për shkak të përfitimit të njëkohshëm të financimit nga një burim tjetër, për të njëjtin aktivitet, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në VKM.

Lidhur me pretendimin se vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit; “...konsiderohet si e padrejtë pasi, pretendon se ka paraqitur pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas një deklaratë zyrtare në të cilën specifikohet qartë se linja buxhetore për shërbimin e avokatit, në kuadër të ndihmës juridike parësore, nuk është e përfshirë në buxhetin e projektit të financuar nga UNDP. Kjo linjë është parashikuar të mbulohet nga DNJF me qëllim shmangien e çdo mbivendosje financimi”, vlerësojmë se ky pretendim **nuk qëndron pasi kjo situatë përbën mbivendosje të burimeve të financimit për të njëjtin aktivitet, në kundërshtim me gërmën “a”, nënndarja “ii”, të pikës 6 të VKM-së nr. 110, datë 06.03.2019, të ndryshuar.**

Së pari, dokumentacioni i përcjellë nga ana e organizatës në lidhje me projektin dhe buxhetin të miratuar nga United Nations Development Programme, është fotokopje jo e noterizuar me origjinalin si dhe në gjuhën angleze (i papërkthyer).

Së dyti, edhe nëse do të merret në shqyrtim dokumenti i sipërcituar, rezulton se objekti i projektit konsiston në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore për një periudhë 12-mujore. Projekti parashikon shtrirjen e këtyre shërbimeve në disa bashki dhe zona të vendit, konkretisht në Vlorë, Himarë, Selenicë, Fier, Lushnjë dhe Berat, me synim garantimin e aksesit efektiv të qytetarëve në drejtësi dhe ofrimin e asistencës juridike për kategoritë përfituese sipas legjislacionit në fuqi.

Nga përmbajtja e dokumentacionit evidentohet se aktivitetet dhe fondet e miratuara janë planifikuar për të mbuluar në mënyrë të vazhdueshme ofrimin e shërbimeve juridike gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit, duke përfshirë si këshillimin dhe orientimin ligjor, ashtu edhe përfaqësimin juridik në rastet e parashikuara. Në këtë kuadër, projekti paraqitet i konceptuar si një ndërhyrje me shtrirje territoriale dhe kohore të përcaktuar qartë, në funksion të përmbushjes së objektivave të tij në lidhje me aksesin në shërbimet e ndihmës juridike falas.

Sa më sipër, nga analiza krahasimore e përmbajtjes së projektit të financuar nga UNDP dhe e aplikimit të paraqitur pranë DNJF-së, rezulton se aktivitetet e propozuara kanë të njëjtin objekt thelbësor, konkretisht ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategori vulnerabel, e cila do të ofrohet dhe në qytete të njejta konkretisht në Vlorë.

Në këtë kuptim, pavarësisht elementeve të tjerë formalë, natyra e aktivitetit, vendi dhe rezultati i synuar mbeten të njëjta, pasi kriteri i përcaktuar në legjislacionin në fuqi lidhet me përmbajtjen dhe objektin e aktivitetit që financohet, dhe jo me elementë të tjerë të veçantë.

Për sa më sipër, Komisioni i Ankimit e konsideron të drejtë vlerësimin që organizata jofitimprurëse “Qendra Psiko-Sociale Vatra” të mos kualifikohet për përfitimin financiar, për shkak të përfitimit të njëkohshëm të financimit nga një burim tjetër **për të njëjtin aktivitet**, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në VKM-në nr. 110/2019, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Ankimit, duke marrë në konsideratë ankimin e depozituar nga **“Qendra Psiko - Sociale Vatra”**, mbështetur në rrethanat e faktit, si dhe dokumentacionin e administruar Komisioni i Ankimit konstaton se Vendimi i Komisionit të Vlerësimit Nr. 08, datë 14.05.2026, është në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”*; Rregulloren *“Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”*, të miratuar me Urdhrin e Ministrit Nr. 393, datë 23.11.2020, dhe Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 4, datë 07.01.2025, *“Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizura nga Ministri i Drejtësisë”*, (i ndryshuar me Urdhrin nr. 124, datë 10.02.2026).

Në këto rrethana, bazuar në Pikat 16, 17 dhe 18, VKM Nr. 110, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”*, Komisioni i Ankimit unanimisht:

VENDOSI:

1. Mospranimin e ankimit të paraqitur nga Organizata Jofitimprurëse **“Qendra Psiko - Sociale Vatra”**.
2. Kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Organizatës jo më vonë se dy ditë nga marrja e vendimit.
3. Ngarkohet Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi sipas parashikimeve ligjore.
4. Kundër këtij vendimi ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative kompetente, brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

KRYETAR

Erjon Ndreca

ANËTAR
Sindi Prifti

ANËTAR
Arsilda Mamica

U shpall në Tiranë,
me datë 01.06.2026.

Ky vendim hartohet në 5 (pesë) kopje.